



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 405/24 Dt. 05.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

Për lejimin e ndryshimeve (aprovimeve) në projekt

1. Miratohet kërkesa e menaxherit të kontratës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për aprovimin e ndryshimeve (kolaudim i kontratës) në projektin: “Trajtimi dhe rrethimi i hapësirave me interes publik”-projekt tre vjeçar, i cili është duke u realizuar nga OE “EDI BAU” shpk & “MBB CONSTRUCTION” shpk, me nr. të prokurimit 622-22-8995-5-2-1.
2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Prokurimit, OE “EDI BAU” shpk & “MBB CONSTRUCTION” shpk dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - OE “EDI BAU” shpk & “MBB CONSTRUCTION” shpk,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.